L I G J
Nr.7825, datë 18.5.1994

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 "PËR TARIFAT DOGANORE", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7654, DATË 24.12.1992; NR.7675, DATË 2.3.1993; NR.7733, DATË 20.7.1993; NR.7792, DATË 9.2.1994 DHE NR. 7793, DATË 14.2.1994

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992, i ndryshuar, neni 9 ndryshohet si vijon:
"Taksat e eksportit për mallra të veçanta që caktohen me ligj, shprehen në përqindje ndaj vlerës doganore të mallrave që eksportohen".

Neni 2

Lista nr.3 "Lista e mallrave për të cilat zbatohen taksat doganore në eksport dhe tarifat përkatëse", si dhe aktet e Këshillit të Ministrave për taksat doganore në eksport, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

Shpallur me dekretin nr.852, datë 30.5.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.